

GJYKATA E QARKUT MITROVICË
P nr. 127/2008
16 shtator 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT MITROVICË, në Trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Charles L. Smith, III si Kryetar, Gjyqtarëve të EULEX-it Klaus Jung dhe Hajnalka Veronika Karpati si anë tarë të Trupit gjykues, me pjesëmarrje të Tara Khan Zyrtare ligjore e EULEX-it si Procesmbajtëse, në lëndën penale kundër:

Xhevat HAXHA, i ngarkuar sipas Aktakuzës PP. nr. 108/08 të parashtruar me datën 24 nëntor 2008 nga Prokurori publik Shyqyri Syla me veprën penale Vrasja në tentativë nga neni 146, në lidhje me nenin 20 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës (KPPK), dhe me veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 Paragrafi (2) i KPPK;

Pas mbajtjes së seancave të gjykimit, të hapur për publikun me datat 13, 14, 15 dhe 16 shtator 2010, të gjithat në praninë e të akuzuarit XHEVAT HAXHA, Avokatit të tij të mbrojtjes Xhafer Maliqi, Prokurorit publik të EULEX-it Adebayo Kareem, palës së dëmtuar Nazmi Mehmeti dhe përfaqësuesit të tij ligjor Abit Asllani (i cili ka munguar me datën 16 shtator 2010);

Pasi që Trupi gjykues e ka ba shqyrtimin dhe votimin me datën 16 shtator 2010, në të njëjtën ditë, në përputhje me nenin 392 Paragrafi (1) të Kodit të procedurës penale të Kosovës (KKPP), në prezencën e publikut, të akuzuarit, Avokatit të mbrojtjes Xhafer Maliqit, Prokurorit publik të EULEX-it Adebayo Kareem, palës së dëmtuar Nazmi Mehmeti dhe përfaqësuesit të tij Abit Asllani, ka shpallë këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **Xhevat HAXHA**, i biri i Xhafer Haxha dhe Xhyla Rexhepi, i lindur me 03 maj 1960 në fshatin Prekaz, komuna e Skenderajt, Shqiptarë i Kosovës, me banim në rrugën Xhafer Deva nr. 33. Mitrovicë, të kryer shkollën fillore, më parë tregtar, momentalisht i papunë, me të ardhura mesatare prej 80 € në muaj nga ndihmat sociale, i martuar, baba i nëntë fëmijëve, më herët i pa dënuar



Është

FAJTOR

I.) Sepse me 09 tetor 2008 rreth orës 17:00, gjatë një mosmarrëveshje në mes të XHEVAT HAXHËS dhe palës së dëmtuar Nazmi Mehmeti në lidhje me çështje të parëndësishme të parkimit, XHEVAT HAXHA e ka nxjerrë armën e tij – një pistoletë Zastava M-70 të kalibrit 9x19mm, pa numër serik, të cilën ai e mbante me vete dhe ka shkrepë së paku tri plumba në Nazmi Mehmetin, duke e qëlluar në dorën e majtë, në gjoks dhe në kokë.

Me këtë, XHEVAT HAXHA ka kryer dhe ka përgjegjësi penale për veprën penale Vrasje në Tentativë në kundërshtim me nenin 146 të KPPK.

II) Sepse XHEVAT HAXHA ka qenë në posedim të armës – një pistoletë Zastava M-70 të kalibrit 9x19mm, pa numër serik – pa autorizim të vlefshëm dhe e ka përdorë armën për të privuar Nazmi Mehmetin nga jeta e tij.

Me këtë, XHEVAT HAXHA ka kryer dhe ka përgjegjësi penale për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me neni 328 Paragrafi (2) i KPPK.

Prandaj, XHEVAT HAXHA

DËNOHET ME

- 12 /dymbëdhjetë/ vjet burgim për veprën penale Vrasje në tentativë (Pika I)
- 4 /katër/ vjet burgim për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve /Pika II/

Dënimi unik është përcaktuar të jetë 15 /pesëmbëdhjetë/ vjet burgim, sipas nenit 71, Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 e KPPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 9 tetor 2008 deri me 25 janar 2010 do të llogaritet në burgim sipas nenit 73 Paragrafi (1) i KPPK.

Në bazë të nenit 60 paragrafi (1) dhe nenit 328, paragrafi (5) të KPPK, konfiskohet arma – Zastava M-70 e kalibrit 9x19mm, pa numër serik.



I akuzuari XHEVAT HAXHA do të kompensoj shpenzimet e procedurë penale, në përputhje me nenin 102 paragrafi (1) të KKPP, përpos atyre për përkthime. Do të lëshohet një aktvendim i veçantë në lidhje me shpenzimet kur të sigurohen këto shënime, në përputhje me 100 Paragrafi (2) i KKPP.

Arsyetimi

A. Historiku procedural

Aktakuzat PP nr. 108/08 e parashtruar në Gjykatën e qarkut në Mitrovicë nga Prokurori publik Shyqyri Sylja me 24 Nëntor 2008, e ngarkon Xhevat Haxhën me veprën penale Vrasja në tentativë nga neni 146, në lidhje me nenin 20 të KPPK, dhe me veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 Paragrafi (2) i KPPK. Aktakuza është konfirmuar me datën 29 nëntor 2009.

Gjyqtarët e EULEX-it e kanë marrë lëndon në punim me datën 15 shkurt 2010. Seanca kryesore është mbajtur me datat 13 deri 16 shtator 2010 përpara Trupit gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it. Fjalët përfundimtare të Prokurorit Adebayo Kareem, Avokatit të mbrojtjes Xhafer Maliqi, dhe palës së dëmtuar Nazmi Mehmeti janë dëgjuar me datën 16 shtator 2010. Të njejtën ditë është shpallur aktakuza.

B. Kompetenca e gjykatës

Sipas nenit 23, Pika 1) i) të Kodit të procedurës penale të Kosovës KKPP, Gjykatat e qarkut janë kompetente të shqyrtojnë lëndët me vepra penale ku është paraparë dënimi me burgim prej së paku pesë vitesh. Në përputhje me nenin 27 paragrafi (1) të KPPK kompetenca territoriale i takon gjykatës në territorin e të cilës është kryer vepra penale.

I pandehuri ngarkohet me veprën penale Vrasje në tentativë, të përcaktuar në nenin 146, dhe lidhur me nenin 20 të KPPK, dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 Paragrafi (2) i KPPK. Për veprën penale të vrasjes është paraparë dënimi minimal prej pesë vjet burgim, ndërsa për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve është paraparë dënimi prej një deri tetë vjet burgim. Aktakuza pohon se i pandehuri e ka kryer veprën penale në Mitrovicë e cila i takon qarkut të Mitrovicës. Prandaj, Gjykata e qarkut e Mitrovicës është autoritet kompetent juridik që të zhvilloj këtë procedurë penale.

Me 15 tetor 2010, pas seancës, Kryetarja e Këshillit të gjyqtarëve të EULEX-it e ka lëshuar vendimin për marrjen e lëndës në punim nga gjyqtarët e EULEX-it në përputhje



me nenin 3.3 të Ligjit mbi kompetenca¹ dhe ja ka caktuar gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e qarkut Mitrovicë. Prandaj, gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në Gjykatën e qarkut në Mitrovicë janë kompetent që të gjykojnë këtë lëndë penale. Trupi gjykues ka qenë i përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Charles L. Smith, III si Kryetar dhe gjyqtarëve të EULEX-it Klaus Jung dhe Hajnalka Veronika Karpati si anëtar.

C. Përmbledhja e provave të parashtruara

Gjatë gjykimit janë dëgjuar këta dëshmitar:

- (1) Nazmi Mehmeti (Pala e dëmtuar), 13 shtator 2010
- (2) Elfate Haxha, 14 shtator 2010
- (3) Naim Salihu, 14 shtator 2010
- (4) Polici Xhevat Jusufi, 14 dhe 15 shtator 2010
- (5) Zeqir Tahiri, 14 shtator 2010
- (6) Bekim Hodaj, 15 shtator 2010
- (7) Armend Bunjaku, 28 prill 2010

Me 15 tetor 2010, këto dokumente janë lexuar për procesverbal:

- (8) Raporti i oficerit nga Bedri Ferati, 09 tetor 2008.
- (9) Raporti i oficerit nga Adnan Deliu, 09 tetor 2008.
- (10) Raporti i oficerit nga Saim Jonuzi, 10 tetor 2008.
- (11) Lista e sendeve të konfiskuara, 10 tetor 2008.
- (12) Raporti forensik për identifikim nga Xhemaljedine Ramaxhiku, 09 tetor 2008.
- (13) Raporti forensik nga Safet Vehapi, 13 tetor 2008 me fotografi (f. 103-123 i dosjes së prokurorit).
- (14) Raporti forensik i ekzaminimit nga Lutfi Raci, 26 dhjetor 2008.
- (15) Përshkrimi i fotografive nga Safet Vehapi (f. 161 i dosjes së prokurorit).
- (16) Foto albumi (f. 164-169 i dosjes së prokurorit).
- (17) 3 Raporte mjekësore nga mjekët Ilir Ahmegjekaj dhe Serbeze Kabashi-Muqaj (f. 170-175 i dosjes së prokurorit).
- (18) Fletë-lëshimi i spitalit nga Mjekët Feti Ahmeti dhe Arsim Morina.

Me 16 tetor 2010, këto dokumente janë lexuar për procesverbal:

- (19) Raporti mjekësor nga Vera Kukaj.
- (20) Raporti mjekësor nga mjekët Nehat Baftiu, Sokol Hajdini dhe Burbuqe Bruqi.

I pandehuri ka zgjedhë që të mos jep deklaratë apo të përgjigjet pyetjeve gjatë gjykimit.

¹ Ligji nr. 03/L-053, Ligji mbi kompetencat, zgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.



D. Vlerësimi i provave të parashtruara

1. Dëshmia e palës së dëmtuar

Në lidhje me faktet e ngjarjes Nazmi Mehmeti ka deklaruar si vijon:

Në pasditen e datës 09 Tetor 2008, Nazmi Mehmeti ishte i ulur përpara dyqanit të vet të argjendarisë në rrugën Xhafer Deva në Mitrovicë me Armend Bunkajun, pronari i dyqanit që është i ngjitur me te. Nipi i tij vjen me veturën e tij dhe ndalet para dyqanit Pantina Commerce që ishte 10-15 metra larg Mehmetit. Pronari i Pantina ka mbërri me kombin e tij pas nipit dhe kërkonte nga ai që ta lëvizte veturën ashtu që të shkarkonte mallin për dyqanin e tij. Në atë moment Xhevat Haxha ka arrit me veturën e vet dhe është ndalë mu para veturës së nipit, aq afër sa tabelat e regjistrimit prekeshin. Prandaj, nipi nuk ka mund ta lëvizë veturën e vet. Nga karriga e tij para dyqanit të vet, Mehmeti thërret nga Haxha dhe ka kërkuar që të lëvizë para. Haxha e ka lëvizë veturën e vet për nja gjysmë metri dhe nipi ishte në gjendje të del nga parkimi dhe të shkoj. Mandej Haxha e ka lëvizë veturën e vet përpara Mehmetit dhe ka dalë nga vettura në drejtim të Mehmetit. Mehmeti është ngritë që të hyjë në dyqanin e tij dhe e ka qenë i kthyer me shpinë kah Haxha. Duart e Mehmetit kanë qenë të futur në xhepat e vet. Armend Bunjaku ka qenë i vendosur në mes të Haxhës dhe Mehmetit. Mehmeti ka qenë rreth dy metra larg dyqanit të tij kur ka dëgjuar nga pas repetimin e revoles dhe është kthyer pas. Në atë moment Haxha ka filluar të shtie nga revolja e tij mbi Armend Bunjakun dhe në drejtim të Mehmetit. Largësia në mes të Haxhës dhe Mehmetit ka qenë përafërsisht dy deri tre metra. Mehmeti në fillim është fshehur prapa Bunjakut dhe ka qenë thjeshtë në duart e tija kur e ka ndi plumbin që i ka hy në trup. Ai është munduar që të ikë për të shpëtuar dhe të mos e vej Bunjakun në rrezik të mëtejme. Haxha e ka ndjekur dhe e ka qëlluar përsëri. Mehmeti është rrëzuar për toke dhe kur e ka ngritur kokën për të shikuar, Haxha e ka qëlluar në kokë. Në total Mehmeti është qëlluar me katër plumba: Dy plumba e kanë qëlluar në kyç të dorës, një plumb ka hy në rajonin e pjesës së parme të sqetullës së majtë, dhe një e ka qëlluar në anën e majtë të kokës së tij.

Gjykata ka ardhë në përfundim se dëshmia e Nazmi Mehmetit është e besueshme. Dëshmia e tij në përgjithësi përputhet me dëshminë që ja ka dhanë policisë me 13 nëntor 2008. Avokati i mbrojtjes parashtronte se dëshmia e Mehmetit nuk është në përputhje me deklaratën e tij të dhanë më parë. Ai e ka bazuar pohimin e tij në tri mospërputhje. Së pari, në deklaratën e policisë, Mehmeti ka thanë se ka kërkuar nga Armend Bunjaku që të porosinë çaj në çastet mu para ngjarjes, por këtë ai nuk e ka përmend në deklaratën e tij. Së dyti, Mehmeti ka deklaruar se ai ka thirr nga Haxha që ta largojë veturën, por kjo nuk qëndron në deklaratën e tij dhanë në polici. Në fund, Mehmeti ka deklaruar se i ka pasë duart në xhepa në momentin para se Haxha ka filluar të shtie me armë, por kjo nuk gjendet në deklaratën e policisë. Kur këto mospërputhshmëri i janë thanë dëshmitarit, atij i është kujtuar se ai e ka lutur Bunjakun për të ju sjell çaj, por Bunjaku nuk ka shkuar sepse askush nuk ishte në tre dyqanet në ato momente. Në lidhje me dy fakte tjera, Mehmeti e ka shpjeguar se Policia e ka kryer intervistën e tyre në spital kur ai ishte në gjendje kritike shëndetësore, dhe nuk ka qenë në gjendje të jep dëshmi të kuptueshme në



lidhje me ngjarjen. Gjykata është në dijeni se intervista ka ndodhë një muaj pas ngjarjes, dhe se Mehmeti ka pësuar lëndime serioze në trupin dhe kokën e tij. Prandaj, Gjykata e pranon sqarimin e tij si të arsyeshëm dhe të besueshëm.

2. Dëshmia e Elfate Haxha

Elfate Haxha ka deklaruar se ajo ka qenë brenda dyqanit të babës saj (i pandehuri) kur ka dëgjuar një “zhurmë” nga jashtë. Në pyetjet e shtruara nga palët Elfate Haxha nuk ka qenë në gjendje ta përshkruaj në asnjë detaj këtë “zhurmë” për të cilën ka thanë se e ka dëgjuar. Në fakt, në një moment të caktuar, ajo ka deklaruar se ka qenë pa vetëdije kur e ka dëgjuat zhurmën.² Pas dëgjimit të kësaj zhurme, ajo ka dalë jashtë për të pa se çka po ndodhë. Ajo e ka pa babën e sajë afër veturës së tij të parkuar para dyqanit Pantina.

Nuk është e qartë se çka ka pa mandej Elfate Haxha. Ajo ka deklaruar se e ka pa Nazmi Mehmetin i cili vinte nga drejtimi i dyqanit të vet dhe duke shkuar në drejtim të Xhevat Haxha³ dhe se Nazmi Mehmeti e kërcënonte dhe e shante babën e saj.⁴ Mirëpo, gjatë disa momenteve kur Prokurori publik i shtronte pyetje, ajo në mënyrë kontradiktore e ka vë në pyetje deklaratën se a është e vërtetë që e ka pa Mehmetin duke sharë:

Prokurori publik: Ku ka qenë Nazmi Mehmeti kur keni dalë ju?

Elfate Haxha: Nuk e kam pa.⁵

Prokurori publik: A keni qenë në gjendje ta shihni ju edhe babën tuaj edhe Nazmi Mehmetin?

Elfate Haxha: E kam pa babën tim afër veturës së tij, dhe ai ka pasë me ardhë me hangër bukë.⁶

Prokurori publik: Ju keni pasë mundësi ta shihni babën tuaj dhe Nazmi Mehmeti?

Elfate Haxha: Unë kam qenë atje, baba im ka qenë përball dyqanit, unë nuk e kam ditë se ata kanë pasë probleme.⁷

Elfate Haxha mandej ka deklaruar se e ka pa Mehmeti duke gjuajt me gur babanë e sajë. Mirëpo, pas pyetjeve të Prokurorit publik është sqaruar se në të vërtetë ajo nuk e ka pa Mehmetin duke gjuajtur me gurë veturën e babës sajë:

Prokurori publik: Dhe e keni dëgjuar derisa e gjuante me gur babanë?

Elfate Haxha: I kam pa gurët mbi veturën e babës tim.

Prokurori publik: A keni pa se kush ka gjuajtur gurë mbi veturën e babës suaj?

Elfate Haxha: Nuk kam pa.

² Procesverbali nga seanca kryesore, 14.09.2010, f. 4.

³ Procesverbali nga seanca kryesore, 14.09.2010, f. 5.

⁴ Procesverbali nga seanca kryesore, 14.09.2010, f. 4 dhe 6.

⁵ Procesverbali nga seanca kryesore, 14.09.2010, f. 5.

⁶ Procesverbali nga seanca kryesore, 14.09.2010, f. 7.

⁷ Procesverbali nga seanca kryesore, 14.09.2010, f. 7-8.



Prokurori publik: Pra ju nuk keni mund ta shihni dhe këte ka mund ta bëj kushdo.
Elfate Haxha: Gurët kanë ardhë prej dyqanit të Nazmi Mehmetit.
Prokurori publik: Por ju nuk e paskeni pa ate duke gjuajtur gurë pra?
Elfate Haxha: Unë nuk e di se kush ka gjuajt gurë, por ato kanë ardhë nga dyqani i tij.⁸

Në fund, Elfate Haxha ka dëshmuar se ajo mandej është kthyer në dyqanin e tyre, i ka treguar nanës dhe dy motrave çka ka pa, dhe që të tria e kanë humbë vetëdijen si konsekuencë. Ajo ka deklaruar se ajo e ka humbur vetëdijen vetëm për shkak të tronditjes kur e ka babën e sajë duke e sharë.

Gjykata ka përfunduar se kjo deklaratë e Elfate Haxhës është e paqartë dhe se përmban deklarata jo-logjike dhe një numër kontradiktash, duke përfshirë edhe kontradiktën në deklaratën që e ka dhanë policisë në natën kur ka ndodhur ngjarja. Prandaj, deklarata e sajë konsiderohet si jo e besueshme.

Në deklaratën e sajë dhanë policisë në të njejtën natë kur ka ndodhur incidenti, Elfate Haxha ka deklaruar se ajo e ka pa Nazmi Mehmetin duke e sharë babanë e sajë dhe duke gjuajtur gurë mbi veturën e tij, dhe mandej Xhevat Haxha e ka nxjerr revolen dhe ka gjuajtur në Mehmetin. Kur është konfrontuar me këtë deklaratë në gjykatë, Elfate e ka mohuar se e ka pa babën e saj kur e ka nxjerrë revolen dhe ka filluar të gjuaj.⁹ Ajo nuk ka thanë se nuk i ka dëgjuar të shtënat, por se ka dëgjuar “zhurmë” pa qenë në gjendje me qenë më deskriptive. Ajo gjithashtu pohon se nuk ka folë me policinë, se policia nuk e ka shënuar deklaratën e sajë me saktësi, dhe se ka qenë pa vetëdije në momentin e intervistimit:

Prokurori publik: A i keni thanë këtë policisë, deklaratën të cilën po sa e lexova?
Elfate Haxha: Jo, vetëm pjesën e parë. Për pjesën tjetër e cila thotë se baba im e ka nxjerrë revolen dhe ka shti me te, këtë nuk e kam pa se ka ndodhë.

Prokurori publik: A keni folë me policinë atë ditë?

Elfate Haxha: Jo.

Kryetari i Trupit gjykues: Ju po sa deklaruat se e keni thanë vetëm pjesën e parë të deklaratës, jo tjetrën, pra a keni folë me policinë atë ditë?

Elfate Haxha: Për ate se çka tha ai tani, unë nuk di të lexoj as të shkruaj, pra nuk e di se çka ka shkruar ai atje.

Kryetari i Trupit gjykues: Por ai po sa e lexoj deklaratën, dhe ju keni thanë pjesa e parë por jo pjesa e dytë, pra a po thoni se keni folë me policinë dhe ata nuk kanë shkruar të gjitha në mënyrë korrekte?

Elfate Haxha: Jo. Unë kam thanë se kam qenë pa vetëdije, pra nuk e di se kush ka ardhë për atë deklaratë.

Prokurori publik: Ju nuk keni folë me policinë?

Elfate Haxha: Jo.

⁸ Procesverbali nga seanca kryesore, 14.09.2010, f. 6-7.

⁹ Procesverbali nga seanca kryesore, 14.09.2010, f. 8 & 11.



Prokurori publik: Në fillim të deklaratës suaj ju keni thanë se keni qenë pa vetëdije kur ka folë policia me juve?

Elfate Haxha: Unë kam thanë se kam qenë pa vetëdije, tani nuk e di se si ka ardhë kjo deklaratë.¹⁰

Pas dëshmisë së saj, gjykata e ka ftuar Oficerin e Policisë së Kosovës *Xhevat Jusufi*, i cili e ka marr deklaratën nga Elfate Haxha. Policin Jusufi i kujtohej ngjarja dhe e mbante në mend që e ka marr deklaratën e Elfate Haxhës në korridor të shtëpisë së familjes së saj. Ai ka dëshmuar se ajo nuk dukej se ndihej e dobët apo e sëmurë dhe se ai e ka informuar për të drejtat e saja. Ai e ka shkruar deklaratën e saj, ja ka lexuar atë, dhe mandej ajo e ka nënshkruar dokumentin, në çdo faqe.

Gjykata beson se deklarata të cilën e ka dhanë Elfate Haxha policisë është e saktë në lidhje me atë se çka ka pa gjatë ngjarjes për disa arsye.

Deklarata është dhanë pas një kohe të shkurtë pasi që ka ndodhur incidenti, kur kujtesa ishte e freskët. Është nënshkruar në çdo faqe me emrin “ELFATE” me germa të mëdha. Faqja e fundit përmban atë se ka thënë se “Pala e dëmtuar apo ankuesi deklaroi se deklarata e sajë i është lexuar me zë dhe e nënshkruan pa vërejtje” dhe se nënshkrimi i sajë është përfundim i kësaj fjalie. Edhe pse Elfate Haxha ka dëshmuar se nuk din shkrim dhe lexim, është e mundur dhe e arsyeshme se personat analfabet dinë se si ta nënshkruajnë emrin e tyre. Gjykata e vëren se emri i saj është i shkruar me germa të mëdha e jo me nënshkrim me germa shkrimi, dhe bile në faqen e dytë ku është shkruar gabimisht “ELFAE”. Gjykata konkludon se kjo është mënyra e arsyeshme se si Elfate Haxha, një person që nuk din shkrim dhe lexim do të nënshkruante një dokument.

Gjithashtu, gjendja faktike në deklaratë përputhet me deklaratën e dëshmitarit Naim Salihu (i përshkrua me detaje të plota më poshtë) i cili e ka dëgjuar një femër të re gjatë ngjarjes e cila ka bërë titull “Babë largohu nga atje” mu para se kanë filluar të shtënat.

Pos kësaj, gjykata konkludon se deklarata e Elfate Haxhës se katër njerëz - Elfate Haxha, nana e saj dhe dy motrat - e kanë humbë vetëdijen vetëm pse Mehmeti e shante Xhevat Haxhën është e pabesueshme. Është më e logjikshme dhe e besueshme se Elfate Haxha e ka pa babën e saj duke e nxjerrë revolen dhe duke shtë në Mehmetin, ashtu sikurse që e ka përshkruar në deklaratën dhanë policisë, dhe se për shkak të kësaj është traumatizuar.

3. Dëshmia e Naim Salihut

Naim Salihu ka dëshmuar se në kohën kur ka ndodhë ngjarja, ai ka shkuar në dyqan për të ble cigare. Po sa ka hy në dyqan ai ka dëgjuar të shtënat. Ai ka dalë nga dyqani dhe i ka pa dy njerëz, njeri më i trashë dhe tjetri i hollë, të cilët kanë qenë 2 – 3 metra larg tij. Ata fjaloseshin në lidhje me parkingun e njëres nga veturat e tyre. Njeri nga ata ka thanë “Nuk mund të parkosh këtu” dhe tjetri është përgjigj “Prit vetëm pak se po shkoj.” Njeriu i dobët atëherë menjëherë e nxori revolen dhe filloj të shtë në atë të trashin. Ata

¹⁰ Procesverbali nga seanca kryesore, 14.09.2010, f. 11.



dy njerëz kanë qenë tre deri katër metra larg njeri tjetrit. Ai i dobëti ka shtënë katër apo pesë herë, dhe ai i trashi ka qenë i qëlluar me plumba.

Kjo dëshmi në përgjithësi përputhet me deklaratën të cilën Naim Salihu ja ka dhanë policisë në ora 18:30 me 09 Tetor 2010, në natën kur ka ndodhë incidenti. Ai i ka thanë policisë se ka qenë duke shkuar në drejtim të bukëpjekësit kur i ka dëgjuar dy njerëz duke u fjalosë. Afër ishte një grua me një vajzë. Ai e ka dëgjuar njërin nga ata burrat duke i thanë tjetrit “Mos shajë, mos shajë”. Vajza ka hy mes burrave dhe ka thanë “Babë shko nga këtu.” Dy njerëzit janë larguar paksa, rreth dy metra larg njeri tjetrit, dhe mandej njeri nga burrat e nxori revolen nga ana e djathë e shokës së tij dhe ka shti në atë tjetrin në pjesët të poshtme të tij. I plagosuri është ngritë dhe është munduar të ikë por burri tjetër ka shti përsëri në kokën e tij.

Ekziston një mospërputhje në mes të dëshmisë dhe deklaratës së Salihut – se a ka qenë e pranishme ndonjë femër gjatë fjalosjes së dy burrave. Gjatë dëshmisë së tij, Salihu është pyetur në mënyrë specifike për persona tjerë që kanë qenë prezent dhe ai ka thanë se kanë qenë vetëm dy burrat. Mirëpo, kur i është lexuar deklarata policore, ai ka ardhë në përfundim se kishte harruar dhe se tani i kujtohet, dhe se ajo që i ka thanë policisë menjëherë pasi që ka ndodhë ngjarja është e saktë dhe e gjithë ajo që e ka pa. Gjykata ka konkluduar se dëshmia e Naim Salihut është e besueshme, dhe e ka pranuar sqarimin e tij për këtë mospërputhje. Deklarata e policisë do merret nga gjykata si rrëfim më i plotë nga ajo që ka pa Salihu.

4. Dëshmia e Zeqir Tahirit

Zeqir Tahiri ka dëshmuar se në kohën e ngjarjes ai ka qenë brenda në dyqan në rrugën Xhafer Deva me disa myshteri. Ai i ka dëgjuar dy apo tri të shtëna nga arma dhe ka dalë jashtë. Ai e ka pa Nazmi Mehmetin me plagë në kokë duke u mbështetë në veturë afër shtyllës elektrike dhe mandej duke ra për toke. Zeqir Tahiri ka shku te ai me vrap dhe së bashku me Armend Bunjakun e kanë vendosë Nazmi Mehmetin në veturë për ta dërgu në spital. Ai ka deklaruar se nuk e ka pa Xhevat Haxhën duke shtënë në Mehmetin, por vetëm e ka pa Haxhën duke kaluar aty pranë rrugës për në shtëpi të vet.

Dëshmia e tij ndryshon nga deklarata e cila është marr nga policia në ora 18:00 në mbrëmjen kur ka ndodhur ngjarja. Tahiri i ka thanë policisë se ai ka qenë brenda në dyqan kur i ka dëgjuar të shtënat. Ai mandej e ka pa Nazmi Mehmetin duke u fshehur pas një veture dhe shtyllës elektrike. Ai e ka pa një revole të zezë dhe i ka thanë Xhevat Haxhës “Mos gjuaj!” Haxha ka qenë për afërsisht tre metra larg nga Tahiri. Haxha ka shkrepë armën e tij në Mehmetin tre herë. Mandej Zeqir Tahiri dhe Armend Bunjaku e kanë vendosë Mehmetin në veturë dhe e kanë dërgu në shtëpi të shëndetit.

Zeqir Tahiri është pyetur për këtë mospërputhje në mes të dëshmisë së tij dhe deklaratës së tij – saktësisht se a e ka pa se Haxha ka shtënë në Mehmetin. Tahiri ka vazhduar të pohoj se ai nuk e ka pa Haxhën me armë dhe nuk e ka pa Haxhën duke shtënë në Mehmetin. Ai mandej ka deklaruar se deklarata në polici nuk i është lexuar atij para se ai e ka nënshkruar dhe se ai nuk e ka lexuar para se e ka nënshkruar.



Gjykata konkludon se deklarata e dhanë nga Zeqir Tahiri policisë, brenda disa orëve nga ngjarja është e vërteta në lidhje me atë se çka ai ka pa. Gjatë dëshmisë së tij, Tahiri ka treguar esencialisht version të ndryshëm. Është një gjë e dyshimtë po qe se dikush ka kujtesë aq shumë të ndryshme për një ngjarje aq të rëndësishme, prandaj gjykata beson se një ndryshim kaq i madh në deklarim mund të jetë si rezultat i kanosjes, ose të paktën, humbje të madhe të kujtesës. Polici Xhevat Jusufi është ftuar përsëri në gjykatë për herë të dytë për të dëshmuar për këtë dëshmitar. Atij i kujtohej kur e ka marr në pyetje Tahirin dhe ka dëshmuar se është praktika e tij normale që të shkruaj së pari deklaratën dhe mandej të ja lexoj atë dëshmitarit. Atij i kujtohet se Tahiri e ka nënshkruar deklaratën në prezencën e tij. Dëshmia e Oficerit të policisë ishte e besueshme, dhe ai nuk ka pas kuruar arsye që ta fabriktoj deklaratën, sikurse që është ba të kuptohet nga Tahiri. Gjithashtu, versioni i dhanë policisë për veprën penale ishte në mënyrë të arsyeshme në pajtim me deklaratat tjera nga dëshmitarët dhe nga pala e dëmtuar.

5. Dëshmia e Bekim Hodaj

Bekim Hodaj ka dëshmuar se ai ka qenë brenda në dyqanin e tij bukëpjekës në rrugën Xhafer Deva kur e ka dëgjuar një zhurmë për të cilën ka menduar se janë fishekzjarrët. Ai nuk ka dalë nga dyqanin i vet, por ka marr vesh më vonë nga myshterijntë të cilët kanë hy brenda se ka pasë të shtëna me armë zjarri. Sipas dëshmisë së tij, ai nuk e ka pa asnjë pjesë të incidentit.

Në mbrëmjen kur ka ndodhur ngjarja, Bekim Hodaj ja ka dhanë deklaratën policisë e cila ka qenë thelbësisht e ndryshme nga dëshmia e tij. Ai ka deklaruar se i ka dëgjuar tri të shtëna nga arma dhe ka shikuar jashtë. Ai e ka pa personin që quhet Xhevat duke e mbajtur një revole me ngjyrë të mbylltë dhe i cili ka shti në Nazmi Mehmetin, i cili është munduar të fshihet prapa veturës dhe shtyllës së ndriçimit. Kur është konfrontuar Bekim Hodaj me deklaratën e tij të më parme, ai ka thanë se policia ka shtuar informata shtesë. Atij nuk i kujtohej se a i është lexuar deklarata e tij para se e ka nënshkruar, por ka qenë i qëndrueshëm në atë se ai vet nuk e ka lexuar para se e ka nënshkruar.

Nga arsyet e njejta sikurse edhe dëshmitari Zeqir Tahiri më parë, gjykata ka ardhë në konkludim se dëshmia e Bekim Hodaj nuk është e besueshme dhe se deklarata e dhanë policisë është e vërtetë dhe e saktë. Deklarata e tij përputhet me deklaratat të dëshmitarëve tjerë dhe të palës së dëmtuar që janë dhanë policisë. Përmban detaje lidhur me të pandehurin dhe për armën e cila tërësisht mungon në dëshminë e tij. Këto janë detaje të rëndësishme që mbahen në mend dhe që janë dhanë menjëherë Oficerit të policisë menjëherë pas të shtënave, kur ngjarja ka qenë e freskët në kujtesën e dëshmitarit. Edhe pse Oficerit të policisë Jusufi nuk i është kujtuar saktësisht Bekim Hodaj, atij i kujtohet se e ka marr deklaratën e tij në dyqanin e bukëpjekësit dhe e ka përsëritë praktikën e tij që të lexoj deklaratën e secilit dëshmitar para se ta nënshkruan. Kur Hodaj është konfrontuar me mospërputhshmëritë rreth asaj se çka ka pa, ai është shprehë se të vetmen gjë që e ka pa është në të vërtetë Pala e dëmtuar duke shkuar në veturë për ndihmë mjekësore. Mirëpo, nuk ka mund në mënyrë të kënaqshme të shpjegojë se si Pala e dëmtuar ka qenë në atë veturë të caktuar ose pse do ta kishte vërejt ai po atë



veturë pasi që, sipas dëshmisë së tij ai as që ka dalë nga dyqani i tij dhe nuk ja ka vu veshin asaj që po ndodhte jashtë.

6. Dëshmia e Armend Bunjakut

Armend Bunjaku nuk është marr më herët në pyetje nga policia apo prokuroria. Sipas dëshmisë së tij me 09 Tetor 2008, ai ka qenë i ulur me Nazmi Mehmetin jashtë dyqaneve të tyre në rrugën Xhafer Deva. Një myshteri ka ardhë dhe ai ka hy brenda në dyqan. Ai e ka dëgjuar një fjalosje jashtë. Ai ka dalë jashtë dhe e ka pa Xhevat Haxhën dhe Nazmi Mehmetin duke u fjalosë. Armend Bunjaku është vendosur në mes dy burrave për ti ndarë ata. Haxha e ka nxjerr revolen dhe ka filluar të shtie në drejtim të Mehmetit. Mehmeti nuk ka pasë asgjë në duart e veta. Ai ka filluar të ikë dhe është qëlluar me një plumb në dorën e tij të majtë. Mehmeti është munduar të fshihet por është qëlluar edhe me një plumb në kokë dhe ka ra në tokë. Armend Bunjaku dhe Zeqir Tahiri kanë shkuar te Mehmeti për ta vendosë në veturë për ta dërguar ti jepet ndihma mjekësore.

Gjykata ka konkluduar se dëshmia e Armend Bunjakut është e besueshme dhe përputhet me deklaratat të dyshuarve tjerë dhanë policisë. Atij nuk i kujtoheshin të gjitha detajet e ngjarjes, por kjo ka qenë e arsyeshme pasi që kanë kaluar dy vite gjatë të cilave as policia dhe as prokuroria nuk kanë folë me te në lidhje me të shtënat. Pa deklaratë zyrtare të marr nga dëshmitari më afër ngjarjes nuk ka qenë e mundur ti freskohet kujtesa.

E. Gjetjet faktike

Në lidhje me konkludimet e mësipërme, gjykata i konsideron këto fakte si të vërtetuara.

Me 09 Tetor 2008, Nazmi Mehmeti dhe Armend Bunjaku kanë qenë të ulur para dyqaneve të tyre në rrugën Xhafer Deva. Në mes të Xhevat Haxhës dhe Nazmi Mehmetit ka ardhë deri te një mosmarrëveshje në lidhje me parkimin e veturave. Armend Bunjaku e ka dëgjuar fjalosjen dhe ka hy mes dy burrave për ti nda. Xhevat Haxha e nxjerr revolen e tij – Zastava M-70 të kalibrit 9x19mm. Mehmeti ka qenë i paarmatosur. Këta dy burra kanë qenë disa metra larg njeri tjetrit kur Haxha ka filluar të shtijë me armën e tij. Haxha ka shti së paku me tre plumba në drejtim të Mehmetit. Mehmeti është munduar të ikë dhe të fshihet pas një veture, por është qëlluar me së paku tre plumba në dorën e majtë, krahun e majtë dhe në anën e majtë të kokës së tij.

F. Kualifikimi ligjor

1. Ligji i aplikueshëm

Gjykata e ka aplikuar Kodin e përkohshëm penal të Kosovës pasi që ai ka qenë kodi penal në fuqi kur është kryer vepra penale. Aplikimi i ligjit të ri, Kodit penal të Kosovës nuk do të ishte më i favorshëm për të pandehurin. Në kësi raste, aplikohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Sa i përket kodit të procedurës penale, trupi gjykuës i



referohet Kodit të procedurës penale të Kosovës si ligj në fuqi në momentin kur është gjykuar lënda penale.

2. Kualifikimi ligjor

Xhevat Haxha ngarkohet me Tentim vrasje sikurse që është përcaktuar me nenet 146 dhe 20 të KPPK. Vrasja kryhet kur kryesi e privon nga jeta personin tjetër në mënyrë të paligjshme. Tentim vrasja kryhet kur kryesi ndërmerr veprim të menjëhershëm dhe qëllimshëm për ta privuar personin tjetër nga jeta, edhe pse vrasja nuk arrihet të kryhet.

Këto fakte tregojnë se Xhevat Haxha ka tentuar ta privoj Nazmi Mehmeti nga jeta e tij:

- Xhevat Haxha me qëllim e ka nxjerr revolen gjatë një fjalosje me Nazmi Mehmetin, i cili ka qenë i paarmatosur.
- Haxha me qëllim ka shti së paku me tre plumba në drejtim të Nazmi Mehmetit.
- Haxha ka filluar të shtijë nga arma e tij në drejtim të Mehmeti nga një largësi e vogël prej disa metrash.
- Haxha ka vazhduar të shtijë nga arma e tij në Mehmetin edhe kur Mehmeti ishte duke ikur.
- Kur ka shti me armë, Haxha nuk e ka pasë cakë shputën e Mehmetit apo nuk ka shti në ajër, por ka shti në trupin e Mehmetit dhe ka qenë në gjendje ta qëlloj disa herë duke përfshirë edhe një herë në kokë.

Xhevat Haxha ka ndërmarr veprim të menjëhershëm dhe të qëllimshëm kur e ka nxjerr armën e vet dhe ka filluar të shtijë me te në Nazmi Mehmetin. Përdorimi i armës vdekjeprurëse nga Haxha nga një distancë e shkurtë prej disa metrave, duke shti në mënyrë si është përshkruar, e vërteton se Haxha ka pasë qëllim ta vras Mehmetin.

Gjykata e ka parasysh se vepra penale ka mund të kualifikohet ndryshe, si Tentim të Vrasjes së rëndë nga neni 147, paragrafi (4) në lidhje me nenin 20 të KPPK. Armend Bunjaku është vendosur në mes dy burrave që janë fjalosë. Në ato momente derisa Bunjaku ende i ndante fizikisht dy burrat, Xhevat Haxha e ka nxjerr revolen dhe ka qëlluar me plumbin e parë në drejtim të Nazmi Mehmetit. Me këtë, Haxha e ka rrezikuar jetën e Armend Bunjakut. Kur vrasja tentohet në mënyrën që me qëllim rrezikohet jeta e personit tjetër përveç atij që është zgjedhur si viktimë, vepra mund të kualifikohet si vrasje e rëndë.

Edhe pse gjykata nuk është detyruar ti përmbahet kualifikimit juridik të parashtruar nga ana prokurorisë në Aktakuzë (parimi *iura novit curia*), ajo është e detyruar ti përmbahet fakteve të pohuara në Aktakuzë.¹¹ Në dispozitivin e Aktakuzës lundër Xhevat Haxhës, nuk përmendet prania e Armend Bunjakut në vendin e ngjarjes asnjëherë. Gjatë shqyrtimit kryesor, Prokurori publik nuk i ndryshuar pohimet faktike në Aktakuzë për të reflektuar praninë e Armend Bunjakut në rrezik kur Xhevat Haxha ka filluar të shtijë në

¹¹ Shih nenin 386 Paragrafi (1) i KKPP.



Nazmi Mehmetin. Edhe pse ky fakt ka dalë në pah gjatë dëshmisë së palës së dëmtuar dhe të dëshmitarit në seancën kryesore, nga arsyeja se Aktakuza nuk është ndryshuar, gjykata nuk ka mund të marr në konsiderim rrezikimin e jetës së Armend Bunjakut dhe ta ndryshoj kualifikimin e veprës penale në përputhje me këtë.

3. Mbrojtja e nevojshme

Në fjalinë e vet përfundimtare Avokati i mbrojtjes Xhafer Maliqi ka pohuar se Xhevat Haxha ka vepruar në mbrojtje të nevojshme në përputhje me nenin 8 të KPK, por ka vepruar në mënyrë disproporcionale me shkallën e rrezikut e cila është kanosë nga pala e dëmtuar, prandaj i ka tejkaluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. Sipas mbrojtjes, Nazmi Mehmeti ka filluar sulmin ndaj Xhevat Haxhës duke e sharë dhe duke ju afruar fizikisht me qëllim që ta sulmoj. Haxha ka reaguar në këtë sulm duke shti me armë një herë në Mehmetin. Mehmeti mandej ka vazhduar të sulmoj duke e sjellë Haxhën në gjendje të traumës së rëndë dhe duke shkaktuar që ai të shtie edhe dy herë në Mehmetin.

Provat nuk e mbështesin versionin e mbrojtjes të fakteve. Nuk ka pasë sulm të menjëhershëm të vërtetë nga Nazmi Mehmeti për të aktivizuar mbrojtjen e nevojshme cila nuk do ta bënte fajtor. Dëshmitë e Nazmi Mehmetit dhe Armend Bunjakut vërtetojnë se Xhevat Haxha dhe Nazmi Mehmeti janë përta me *fjalë* kur Armend Bunjaku ka hy mes tyre dhe i ka nda. Mehmeti ka qenë i paarmatosur. Nuk ka asnjë dëshmi nga askush se Mehmeti ka ndërmarrë çfarëdo veprimi *fizik* me të cilin kishte me dhanë ndonjë shenjë se ka për qëllim ta sulmoj Haxhën. Fjalosja apo sharjet nuk janë sulm i vërtetë sikurse që është paraparë me nenin 8 të KPPK. Dëshmitë e Nazmi Mehmetit, Armend Bunjakut dhe Naim Salihut, sikurse edhe deklaratat dhanë policisë të Elfate Haxhës dhe Zeqir Tahirit, të gjitha vërtetojnë se Haxha e ka nxjerr revolen dhe ka filluar të shti në Mehmetin pa ndonjë provokim fizik. Deklaratat e Nazmi Mehmetit dhe Armend Bunjakut dhe deklaratat dhanë policisë të Naim Salihut dhe Bekim Hodajt gjithashtu e konfirmojnë se Nazmi Mehmeti ikte duke u munduar të fshihet prej plumbave pas një veture, kur Haxha ka vazhduar të gjuaj nga arma në drejtim të tij duke e qëlluar në kokë. Prandaj, mbrojtja se Haxha kishte vepruar në mbrojtje të nevojshme për ti ju shmangë sulmit të vërtetë dhe të çastit nuk qëndron.

G. Propozimet e refuzuara

Me 14 Shtator 2010, Avokati i mbrojtjes Maliqi ka propozuar që deklarata dhanë në polici nga ana e Elfate Haxhës të shpallet si e papranueshme sipas nenit 89 të KKPP sepse Elfate Haxha ka pohuar se nuk din shkrim dhe lexim. Gjykata e ka refuzuar këtë propozim me 15 Shtator 2010. Neni 89 është i aplikueshëm për personin kundër të cilit është ndërmarr ndonjë veprim hetimor. Elfate Haxha është marr në pyetje si dëshmitare dhe jo si e dyshuar, prandaj ajo nuk ka qenë e nënshtruar ndonjë veprimi hetimor. Por, edhe po qe se neni 89 do të ishte i aplikueshëm, pasi që deklarata i është lexuar Elfate Haxhës dhe ajo e ka nënshkruar çdo faqe, kushtet teknike nga neni 89 do të konsideroheshin si të plotësuar.



Me 15 Shtator 2010, Avokati i mbrojtjes Maliqi ka propozuar që deklarata e Zeqir Tahirit dhanë në polici të shpallet e papranueshme sipas nenit 87 të KKPP, sepse nuk është nënshkruar në mënyrë të duhur nga ana e dëshmitarit. Gjykata e ka refuzuar këtë propozim sepse çdo faqe e deklaratës e mban nënshkrimin e Zeqir Tahirit. Fakti se ai ndoshta nuk e ka lexuar deklaratën para se e ka nënshkruar nuk ndikon në pranushmërinë e provës.

Me 15 Shtator 2010, Avokati i mbrojtjes Maliqi ka propozuar që gjykata ta bëjë rekonstruktimin e vendit të ngjarjes në praninë e ekspertëve të forensikës dhe atyre balistik. Gjykata e ka refuzuar këtë propozim sepse një rekonstruktim i tillë nuk do të shtonte asgjë të vlefshme provave. Dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat të cilat i janë parashtruar gjykatës kanë qenë të mjaftueshme për ti vërtetuar faktet e lëndës.

H. Dënimi

Kur e shqipton sanksionin penal, gjykata duhet të ketë parasysh edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit për ti ndalë aktivitetet e rrezikshme sociale ashtu që të tjerët të përmbahen nga kryerja e veprave të ngjashme penale, edhe qëllimit specifik, që të parandalohet kryesi nga përsëritja e kryerjes së veprës penale. Në këtë rast, Trupi gjykues ka ardhë në përfundim se vetëm me aplikimin e këtij dënimi me burgim mund të arrihet qëllimi i dyfishtë i lartpërmendur. Të shtënat me armë ndaj Nazmi Mehmetit ishin veprime të pakuptimta me dhunë të skajshme të kryer nga fqiut ndaj fqiut tjetër për shkak të një çështje të parëndësishme të parkingut. Xhevat Haxha ka kryer një veprim të tillë ndaj personit me të cilin nuk kishte ndonjë çështje të pazgjedhur të mëhershme dhe me të cilin ka qenë fqinj mbi dhjetë vite. Prandaj dënimi i shqiptuar ka pasë për qëllim që të parandaloj Haxhën që të kryej dhunë edhe ndaj ndonjërit fqinj, shok apo person tjetër për shkak të ndonjë mosmarrëveshje të vogël dhe duke i dërguar porosi shoqërisë se kesi lloj kundërveprimi i tepruar me dhunë për shkak një çështje të rëndomtë e cila duhet dhe mund të zgjidhet në mënyrë shoqërore nuk do të tolerohet.

Në bazë të nenit 64, paragrafi (1) i KKPP, gjatë përcaktimit të zgjatjes së dënimit, gjykata duhet ti vlerësoj të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues.

Gjykata e ka konsideruar si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri ka nëntë fëmijë dhe më parë nuk ka qenë i dënuar. Sa i përket vetëm veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, gjykata e ka konsideruar si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri për këtë veprë penale është deklaruar si i fajshëm.

Gjykata i ka marr si rrethana rënduese veprimin posaçërisht të pakuptimtë dhe të dhunshëm e të pandehurit, plagët e rënda të shkaktuara ndaj viktimës, vuajtjet e viktimës të cilat edhe më tutje vazhdojnë, fakti se viktimja ka mbetur invalid i përhershëm dhe efekti shkatërrues i kësaj në personalitetin e tij, familja e tij dhe gjendja e tij ekonomike, fakti se i pandehuri ka mbajtur me vete armën e mbushur gjatë aktivitetëve të tija ditore të rregullta në vend urban të ngjeshur me shumë njerëz dhe fëmijë të pranishëm, fakti që i



pandehuri nuk ka ndërmarr asnjë hap për pajtim as personalisht as përmes ndërmjetësuesve gjatë dy viteve prej se është kryer vepra penale, dhe mungesa e pendimit të cilën e tregonte i pandehuri.¹²

Për veprën penale të Vrasjes në kundërshtim me nenin 146 të KPPK, ligji parasheh dënimin minimal prej pesë (5) viteve burgim. Kur kryesi tenton të kryej veprën penale për të cilën është paraparë dënimi minimal prej tre (3) vitesh burgim, vetë tentativa do të dënohet (neni 20 paragrafi (2) i KPPK), mirëpo dënimi i shqiptuar nuk do të jetë më tepër se tri të katërtat e dënimit maksimal të paraparë për veprën penale (neni 65 paragrafi (2) i KPPK). Dënimi maksimal me burgim i paraparë me ligj është 20 vjet (neni 38 paragrafi (1) i KPPK), prandaj dënimi maksimal i lejuar për veprën penale Tentim vrasje është pesëmbëdhjetë vjet. Duke e aplikuar nenin e cituar dhe duke i konsideruar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, për këtë veprën penale gjykata e ka shqiptuar dënimin prej dymbëdhjetë (12) vitesh burgim.

Për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328 Paragrafi (2) i KPPK, ligji parasheh dënim me të holla ose dënim me burgim prej një deri tetë vite. Gjykata për këtë veprën penale e ka shqiptuar dënimin prej katër (4) viteve me burgim.

Pasi që Xhevat Haxha ka kryer dy vepra penale, në bazë të rregullave për llogaritjen e dënimit unik, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se secili dënim i veçantë, por dënimi nuk mund të arrij shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara. Prandaj, gjykata e ka shqiptuar dënimin unik prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh burgim.

Xhevat Haxha ka qëndruar në paraburgim nga data 09 Tetor 2008 deri me 25 janar 2010. Kjo periudhë do të llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, në përputhje me nenin 73 Paragrafi (1) i KPPK.

I. Gjësendet e konfiskuara

Në bazë të nenit 60 paragrafi (1) dhe nenit 328 paragrafi (5) të KPPK konfiskohet arma - Zastava M-70 e kalibrit 9x19mm revole pa numër serik, e përdorur për kryerjen e veprës penale.

J. Shpenzimet

I pandehuri do të kompensoj shpenzimet procedurës penale, në përputhje me nenin 102 paragrafi (1) të KKPP përpos shpenzimeve për përkthim. Një aktvendim i veçantë me vlerat e shpenzimeve do të lëshohet nga gjykata, kur të mblidhen informatat e duhura, në përputhje me nenin 100 Paragrafi (2) i KKPP.

¹² Gjykata nuk ka mund të marr parasysh si të sinqertë kërkim faljen që e ka ofruar Xhevat Haxha e cila është ba në fund të gjykimit në fjalën e tij.



Gjykata e qarkut Mitrovicë
P. nr. 127/08

E përpiluar në Gjuhën Angleze si gjuhë e autorizuar.

Procesmbajtëse
Tara Khan

Kryetari i Trupit gjykues
Charles L. Smith, III

Anëtar i Trupit gjykues
Klaus Jung

Anëtare e Trupit gjykues
Hajnalka Veronika Karpati

Mjeti juridik: Personi i autorizuar mund të parashtoj ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi Gjykatës supreme të Kosovës përmes Gjykatës së qarkut të Mitrovicës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit, në bazë të nenit 398 Paragrafi (1) i KKPP.

